



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi	26.01.2022	2	2022
Organizimi	SKPMHC	353/2022	1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1179/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli-Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1179/2021 të datës 16.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë

në Komunën e Rahovecit, kundër organit të punësimit/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1179/2021 të datës 16.12.2021 të parashtruar nga ankuesi nga Rahoveci.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 12.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6178/2021 të regjistruar me numër A.nr.1179/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Krijimin e Grupeve Prodhuese dhe për Masën Financiare në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



Këshilli, me datë 13.01.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:6178/2021 të regjistruar me numër A.nr.1179/2021 të datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën në emër të ankuesit; Certifikatën 15-15.06.2011; Certifikatën korrik 2013; Certifikatën 2018; Certifikatën e datës 09.06.2002; Certifikatën prill 2018; Pasqyrën nga Trusti Pensional i Kosovës; Njoftimin për test me shkrim dhe me gojë; Njoftimin lidhur me kërkesën për shprehej të interesit; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Krijimin e Grupeve Prodhuese dhe për Masën Financiare; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 13.01.2022; Kërkesë për informata zyrtare e datës 14.01.2022 dhe Përgjigjen e datës 17.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Lartë për Krijimin e Grupeve Prodhuese dhe për Masën Financiare në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është zviluar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Sipas dispozitave të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, përcaktohet se: *Institucion i administratës shtetërore - është Zyra e Kryeministrit, një ministri, një agjenci ekzekutive, një agjenci rregullatore, duke përfshirë degët lokale të tyre; ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se, Institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune.*

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 34 paragrafi 1, 2 dhe 3, ka përcaktuar se: *1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse).*

Kolegji, në kuptim të dispozitave të lartcekura ka konstatuar se pranimi në Shërbimin Civil bëhet përmes procedurës së konkurrimit, e cila organizohet nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore, për çdo institucion tjetër.

Andaj, meqenëse se në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë që dëshmon se kjo procedurë e rekrutimit është zhvilluar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe duke



marr parasysh njoftimin e datës 13.01.2022 të Divizionit për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku ceket se: *Këtë procedurë e ka zhvilluar Banka Botërore në kuadër të MBPZHR, mirëpo Divizioni i Burimeve Njerëzore nuk posedon asnjë dokumentacion*, Kolegji konstaton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil dhe as kandidatit për pranim në Shërbimin Civil, sepse pranimi në Shërbimin Civil mund të bëhet vetëm përmes konkursit të organizuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (për institucionet e administratës shtetërore), dhe Njësia e Burimeve Njerëzore (për çdo institucion tjetër shtetëror).

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli shqyrton dhe merr vendime për *ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil*, si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo të kandidatit për pranim në shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1179/2021 të datës 16.12.2021 të parashtruar nga ankuesi


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1179/2021

Valentina Kaçandolli-Bekteshi


Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MBPZHR-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

